



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Agjencia Për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit PENSIONAL

Agjencia Për Mbikëqyrje të  
Financimit Kapital të Sigurimit PENSIONAL

Nr. 01-948/6

13.10.2021

SHKUP

PLANI FINANCIAR I AGJENCISË PËR  
MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL  
TË SIGURIMIT PENSIONAL PËR VITIN  
2022

## Përmbajtja

I. Hyrje .....	3
II. PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2022 .....	5
1. TË ARDHURA TË PLANIFIKUARA .....	5
1.1 Kompensime nga kontribute nga shoqëritë pensionale.....	5
1.2 Kompensime administrative.....	5
1.3 Të ardhura nga kamatat .....	5
2. SHPENZIMET E PLANIFIKUARA .....	6
2.1 Materiale të shpenzuara.....	6
2.2 Energjia e shpenzuar dhe shërbimet komunale .....	6
2.3 Mirëmbajtja investuese e mjeteve .....	6
2.4 Shërbime të tjera.....	6
2.5 Shërbimet e bartjes-transportit .....	8
2.6 Shpenzime për reklama dhe reprezentacion.....	8
2.7 Qiramarrja .....	8
2.8 Shërbime të tjera materiale.....	8
2.9 Provizioni për qarkullim pagesor .....	9
2.10 Premitë e sigurimit .....	9
2.11 Shpenzime ditore dhe të udhëtimeve.....	9
2.12 Anëtarësime.....	9
2.13 Shërbime intelektuale dhe shërbime të tjera.....	Error! Bookmark not defined.
2.14 Shpenzime tjera .....	Error! Bookmark not defined.
2.15 Mjete për punë ndërtimore .....	Error! Bookmark not defined.
2.16 Mjete për pajisje .....	Error! Bookmark not defined.
2.17 Mjete të tjera kapitale.....	Error! Bookmark not defined.
2.18 Paga dhe kompensime të kalkuluara .....	Error! Bookmark not defined.
2.19 Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati .....	Error! Bookmark not defined.
Shtojca 1 Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional - Pasqyra analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve .....	13
Shtojca 2 Rezultati i planifikuar financiar për vitin 2022.....	18

# Plani financiar për vitin 2022 i Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)

## I. Hyrje

Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) është trup rregullator i pavarur dhe i mëvetësishëm i formuar në bazë të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113 /2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016 dhe 21/2018) (në tekstin e mëtejshëm: Ligji)

Në pajtim me nenin 46 të Ligjit, Agjencia ka cilësi të personit juridik me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin. Organ Drejtues dhe Mbikëqyrjes i Agjencisë është Këshilli i Ekspertëve, ndërsa për punën e tij përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i themelimit të saj është mbrojtja e interesave të anëtarëve të fondeve pensionale dhe nxitja e zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital. Agjencia është themeluar për të realizuar mbikëqyrje të punës së shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, shoqërive për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtejshëm: shoqëritë pensionale) dhe fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtejshëm: fondet pensionale).

Në pajtim me nenin 47 të Ligjit, Agjencia është kompetente që të:

- japë, tërheqë dhe marrë lejet për themelimin e shoqërive pensionale dhe lejet për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale;
- të mbikëqyrë punën e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale me të cilat menaxhojnë, si dhe të ruajtësve të mjeteve të fondeve pensionale të menaxherëve të huaj të mjeteve;
- promovojë, organizojë dhe nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe ta rrisë vetëdijen e publikut për qëllimet edhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale;
- miratojë akte në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital dhe Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale në sigurimin pensional me financim kapital, si dhe udhëzimet profesionale, doracakët, etj., në lidhje me sigurimin pensional me financim kapital dhe të iniciojë miratimin e rregulloreve dhe akteve të tjera në lidhje me shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale me të cilat menaxhojnë.

Puna e Agjencisë në pajtim me nenin 56 paragrafi (3) të Ligjit, financohet nga kompensimet të cilat i arkëton Agjencia nga shoqëritë pensionale (kompensim mujor nga secila shoqëri pensionale dhe kompensime administrative). Pëlqimi për shumën e kompensimit jepet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në bazë të propozimit të përcaktuar nga ana e Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë.

Shuma e kompensimit mujor që e arkëton Agjencia nga shoqëritë pensionale, përcaktohet në bazë të analizës për nevojat e Agjencisë për realizim optimal të kompetencave të përcaktuara dhe duke respektuar parimin e minimizimit të shpenzimeve. Në këtë drejtim, vërehet trend rënës i shumës së kompensimit prej 1,5% në vitin 2006 dhe 2007, në 1% në vitin 2008 dhe 2009 dhe prej 0,8% në vitin

2010 deri në vitin 2021. Shuma e kompensimit mujor prej 0,8% të kontributeve të përgjithshme, të paguara gjatë muajit të kaluar në secilin fond pensional me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, planifikohet edhe për vitin 2022.

*Propozim-plani financiar i Agjencisë për vitin 2022 është përcaktuar në bazë të:*

- Realizimit të Planit Financiar për vitin 2021.
- Kompensimeve të pritshme dhe të ardhurave tjera gjatë vitit 2022.
- Realizimi i aktiviteteve të filluara dhe aktiviteteve të reja sipas programit vjetor të punës së Agjencisë për vitin 2022 dhe
- Shpenzimet e planifikuara për vitin 2022.



## II. PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2022

Në bazë të supozimeve të theksuara paraprake, për vitin 2022 planifikohen këto të ardhura dhe shpenzime të Agjencisë.

### 1. TË ARDHURA TË PLANIFIKUARA

Gjatë vitit 2022, planifikohet që Agjencia të realizojë të ardhura të përgjithshme prej 75.600.000 denarë, struktura e tyre sipas burimit të mjeteve është si vijon:

1.1 Kompensimi nga kontributet e shoqërive pensionale	71.000.000 denarë
1.2 Kompensime administrative	3.800.000 denarë
1.3 Të ardhura nga kamatat	800.000 denarë

TË ARDHURA TË PËRGJITHSHME TË PLANIFIKUARA 75.600.000 denarë

Shuma e planifikuar e të ardhurave nga kontributet e shoqërive pensionale prej 71.000.000 denarë pritet që të realizohet me arkëtimin e kompensimit mujor nga shoqëritë pensionale prej 0,8% të kontributeve të përgjithshme, të paguara gjatë muajit të kaluar në secilin fond pensional me të cilin menaxhon shoqëria pensionale. Të ardhurat e planifikuara nga kompensimi mujor janë të përlllogaritura në bazë të kontributeve të projektuara me projektimet aktuale të Fondit të SPIM për vitin 2022 të marra në vitin 2015 dhe duke marrë parasysh se në vitin 2021 jemi njoftuar se Fondi i SPIM nuk ka përditësime të projeksioneve, Agjencia realizoi vlerësime në bazë të të dhënave të kaluara dhe në bazë të projekteve buxhetore në klasën e shpenzimeve tranzituese nga Fondi i SPIM.

Shuma prej 3.800.000 denarë paraqet të ardhura në bazë të kompensimeve administrative, shuma e të cilave projektohet në nivel përafërsisht të njëjtë siç është realizuar edhe në vitet paraprake.

Shuma prej 800.000 denarë janë të ardhura të planifikuara nga kamatat të cilat Agjencia pritet t'i arkëtojë nga depozitat e afatizuara nga fondi rezervë i bankave të caktuara, në pajtim me Vendimin për shpërndarjen dhe investim të tepricës së të ardhurave të Agjencisë.

## **2. SHPENZIMET E PLANIFIKUARA**

Gjatë planifikimit të shpenzimeve për punën e Agjencisë gjatë vitit 2022, është marrë parasysh shpenzimi racional i mjeteve të nevojshme për realizimin kualitativ, efikas dhe të vazhdueshëm të detyrave, obligimeve dhe kompetencave të Agjencisë që dalin nga Ligji për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital.

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2022 planifikohen që të jenë **75.250.000** denarë dhe planifikohen që të shfrytëzohen për nevojat si vijon:

### **2.1 Materiale të shpenzuara**

Për furnizim me materiale të nevojshme për funksionimin e përditshëm të Agjencisë, në vitin 2022 janë planifikuar të shpenzohen **610.000** denarë edhe atë për blerjen e:

- Derivateve;
- Materialeve për zyrë dhe
- Inventarit të imët

Shpenzimet e planifikuara për Materialet e shpenzuara në vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara për të njëjtën bazë gjatë vitit 2021.

### **2.2 Energjia e shpenzuar dhe shërbimet komunale**

Për shpenzimet e **energjisë elektrike dhe pagesën e shërbimeve komunale** gjatë vitit 2022, janë planifikuar shpenzime në shumë prej **1.400.000** denarë edhe atë për:

- Energji elektrike dhe
- Ujë, shpenzime të tjera komunale dhe ngrohje qendrore

Shpenzimet e planifikuara për Energjinë elektrike janë **800.000** denarë dhe rritja është si rezultat i pritjes për ndryshim të çmimit të energjisë elektrike të tregut të lirë.

Shpenzimet e planifikuara për Energjisë e harxhuar dhe shërbimet komunale në vitin 2022 janë më të larta për **17%** krahasuar me shpenzimet e planifikuara në sipas bazës së njëjtë për vitin 2021.

### **2.3 Mirëmbajtja investuese e mjeteve**

Shpenzimet e planifikuara për Mirëmbajtje investuese të mjeteve janë **30.000** denarë edhe atë për:

- Instalim dhe mirëmbajtje të sistemit të zjarrit

Shpenzimet e planifikuara për **Mirëmbajtje investuese të mjeteve** janë më të ulëta për afro **90%** krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022 për shkak të centralit tashmë të instaluar në vitin 2021.

### **2.4 Shërbime të tjera**

Mjetet e vlerësuara për atë kategori të shpenzimeve me shumë të përgjithshme prej **15.800.000** denarë, planifikohen që të dedikohen për:

- Mirëmbajtje të softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional;
- Mirëmbajtje të pajisjes harduerike IBM;

- Mirëmbajtje të softuerit për arkivin;
- Mirëmbajtje të softuerit për kontabilitet;
- Shërbime për lokacion sekondar;
- Dërgesa postare;
- Mirëmbajtje higjienike të hapësirave;
- Shërbime të telekomunikimeve;
- Shërbime për printim, kopjim dhe konvertim të letrave;
- Kompensim për hapësirën e parkimit;
- Mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve;
- Mirëmbajtje të pajisjes teknike dhe
- Rregullime të objektit zyrtar
- Aktivitete informative për zhvillim të sigurimit pensional me financim kapital
- Servis informativ-financiar.

Shpenzimet e planifikuara për Shërbime tjera i përmbajnë shpenzimet për realizim të veprimtarisë siç janë për mirëmbajtjen e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional, mirëmbajtjen e IBM pajisjes harduerike, mirëmbajtjen e softuerit për arkivin dhe kontabilitetin dhe orët e punës për mirëmbajtjen e atyre softuerëve nga ana e një firme të jashtme për teknologji informatike. Lokacioni sekondar është i nevojshëm për të mbrojtur të dhënat dhe aplikacionet, si dhe mbrojtjen e mosfunksionimit të pajisjeve ose mosqasjes së lokacionit primar të parametrave informatike. Në këtë drejtim, blihet zgjidhja complete e subjektit të jashtëm në largësi minimale prej 100km largësi rrugore dhe 80km largësi ajrore nga lokacioni primar. Mirëmbajtja e lokacionit sekondar dhe pajisjeve për parametra informatike është një hallkë e rëndësishme në sistemin e menaxhimit me sigurinë e informatave për autorizim dhe parevokueshmëri.

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtje të softuerit për shtyllën e dytë dhe tretë është 4.300.000 denarë. Rritja është si rezultat i përplotësimeve më të mëdha softuerike gjatë 3 viteve të kaluara dhe ato kërkojnë më shumë mjete për mirëmbajtjen e tyre.

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen e softuerit për kontabilitet janë 720.000 denarë. Nevoja për vendosjen e përplotësimit të softuerit për funksionalitete plotësuese në punë për mbajtje të kontabilitetit të Agjencisë.

Shpenzimet e planifikuara për Mirëmbajtje të pajisjes harduerike IBM është 1.200.000 denarë. Shpenzimet janë planifikuar për mirëmbajtje të saj të rregullt, servis dhe zëvendësim eventual të pajisjes jofunksionale.

Shpenzimet e planifikuara për Aktivitete informative i përfshijnë shpenzimet për shërbime për promovimin, organizimin dhe nxitjen e zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital janë 5.000.000 denarë. Obligimi ligjor i Agjencisë është të caktojë mjete që kanë të bëjnë me aktivitetet informative për anëtarët e fondeve pensionale me qëllim të rritjes së vetëdijes së anëtarëve dhe publikut për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, për përfitimet nga anëtarësimi në fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, përfshirë edhe qëllimet, parimet dhe përfitimet nga pjesëmarrja në skemën pensionale profesionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për çështje tjera në lidhje me sigurimin pensional me financim kapital. Një pjesë e shpenzimeve të Agjencisë në vitin 2022 planifikohet për aktivitete për organizim të evenimentit “15 Shtator – Dita e ndërgjegjësimit pensional” që mbahet çdo vit në periudhën rreth 15 shtatorit me qëllim rritjen e vetëdijes së publikut për sigurim pensional me financim kapital.

Shpenzimet e planifikuara për Shërbime tjera në vitin 2022 janë më të larta për 27% krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2021.



## **2.5 Shërbimet e bartjes-transportit**

Për blerje të shërbimeve për bartje - transport të taksive për nevojat e Agjencisë në vitin 2022 janë planifikuara **60.000 denarë**.

Shpenzimet e planifikuara për **Shërbimet e bartjes-transportit** në vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara në të njëjtën bazë gjatë vitit 2021.

## **2.6 Shpenzime për reklama dhe reprezentacion**

Për reklama dhe reprezentacion në vitin 2022 janë planifikuara shpenzime prej 700.000 denarë të dedikuara për:

- Representacion dhe
- Shërbime për botimin e materialit reklamues

Shpenzimet e planifikuara për **reklama dhe reprezentacion** në vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara në të njëjtën bazë gjatë vitit 2021. Shërbimet për botim të materialit reklamues janë dedikuar për evenimente të cilat Agjencia i realizon me mbikëqyrës tjerë financiarë në shtetin me qëllim rritjen e vetëdijes për edukim financiar dhe inkluzim financiar të publikut. Përmes trupit koordinativ të mbikëqyrësve financiarë realizohen eventet “Dita e vetëdijes financiare” dhe “Java globale e parave”

Shpenzimet e planifikuara për Representacion kanë të bëjnë me organizimin e evenimenteve zyrtare dhe prokurimet për nevojat e Agjencisë.

Shpenzimet e planifikuara për **Shpenzime për reklama dhe reprezentacion** në vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2021.

## **2.7 Qiramarrja**

Për vitin 2022 janë planifikuar shpenzime në shumë prej **1.360.000 denarë** për:

- Qiramarrje të sallave dhe amfiteatrove;
- Qiramarrje të linjës së internetit;
- Qiramarrje të pajisjeve të tjera dhe
- Qiramarrje (lizing) të automjeteve.

Mjetet e planifikuara për qiramarrje janë për marrje me qira të sallave dhe amfiteatrove për nevojat e Agjencisë, marrje me qira të linjës së internetit dhe pajisjeve të tjera, respektivisht të printerëve dhe skanerëve për nevojat e Agjencisë dhe marrje me qira (lizing) të automjeteve.

Shpenzimet e planifikuara për qiramarrje (lizing) të automjeteve janë 1.100.000 denarë. Agjencia në vazhdimësi përmes lizingut operativ për tre vjet siguron automjete zyrtare. Automjetet janë në klasën e automjeteve me madhësi të mesme dhe nivel të pajisjes, që shfrytëzohen për nevojat zyrtare të Agjencisë në aspekt të supervizionit dhe rregullativës. Rritja është si rezultat i pritjes për ndryshim të çmimeve në tregun lizing.

Shpenzimet e planifikuara për qiramarrje për vitin 2022 janë më të lartë për afro 35% në krahasuar me shpenzimet e planifikuara në të njëjtën bazë gjatë vitit 2021.

## **2.8 Shërbime të tjera materiale**

Në zërin Shërbime të tjera materiale janë planifikuar shpenzime në shumë prej **380.000 denarë** për:



- Blerjen e revistave, literaturës profesionale, gazetave dhe të ngjashme;
- Pagesë të kompensimit për shkëmbimin e të dhënave të bursave dhe shpenzimeve të arkës – materiale;
- Shpenzime për blerjen e mjeteve higjienike;
- Sigurim teknik dhe patrullues të hapësirave të Agjencisë;
- Shpenzime për regjistrim dhe kontroll teknik të automjeteve dhe
- Shërbime për deratizim dhe dezinfektim

Shpenzimet e planifikuara për **Shërbime të tjera materiale** për vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2021.

## 2.9 Provizioni për qarkullim pagesor

Mjetet e kësaj kategorie shpenzuese janë 60.000 denarë, ndërsa kanë të bëjnë me provizionet e qarkullimit pagesor dhe provizionet bankare për blerje të devizave.

Shpenzimet e planifikuara për Provizionin e qarkullimit pagesor për vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë në vitin 2021.

## 2.10 Premitë e sigurimit

Për vitin 2022 janë planifikuara shpenzime në shumë prej **110.000 denarë** për:

- Sigurimin e të punësuarve të Agjencisë;
- Sigurimin e udhëtarëve për udhëtime zyrtare jashtë vendit;
- Sigurimi i objektit zyrtar nga fatkeqësitë dhe
- Sigurimi i automjeteve zyrtare

Shpenzimet e planifikuara për **Premitë e sigurimit** për vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë në vitin 2021.

## 2.11 Shpenzime ditore dhe të udhëtimeve

Shuma e planifikuar e shpenzimeve për udhëtime zyrtare në vend dhe jashtë është vlerësuar në **1.600.000 denarë**. Këto shpenzime përfshijnë: shpenzime për akomodim, ushqim dhe transport (mëditje për udhëtim zyrtar, shpenzime për bujtje dhe shpenzime të tjera në lidhje me ato udhëtime). Mëditjet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit rregullohen me Aktvendim për shumat më të larta të mëditjeve për udhëtime zyrtare dhe transfere jashtë vendit, shpenzime që u pranohen organeve të administratës shtetërore si shpenzime vijuese (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 19/14 që është në fuqi prej datës 01.01.2015).

Shpenzimet e planifikuara për Shpenzime ditore dhe të udhëtimeve për vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2021.

## 2.12 Anëtarësime

Planifikohet që gjatë vitit 2022 Agjencia të paguajë **440.000 denarë** për:

- Anëtarësi vjetore në IOPS - Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve Pensionalë;
- Anëtarësi vjetore në Organizatën e Punëdhënësve të Maqedonisë;

- Anëtarësi vjetore në INFE – Rrjetin ndërkombëtar të Arsimit Financiar dhe OECD – Organizatën për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik dhe
- Anëtarësi vjetore në Shoqatën e revizorëve të brendshëm.

Shpenzimet e planifikuara për Anëtarësime për vitin 2022 janë në të njëjtin nivel krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2021.

### **2.13 Shërbime intelektuale dhe shërbime të tjera**

Shpenzimet e planifikuara për shërbime intelektuale dhe shërbime tjera për vitin 2022 janë në shumë prej 2.900.000 denarë. Planifikohet që ato të shfrytëzohen për pagesë për:

- Kompensim për anëtarët e jashtëm të Këshillit të Ekspertëve;
- Shërbime të tjera – vlerësues, noter;
- Përkthime të teksteve;
- Lektorim të teksteve;
- Revizion të jashtëm;
- Shërbime konsultuese;
- Trajtime për përsosje profesionale, seminare dhe konferenca;
- Kontroll shëndetësor të të punësuarve;
- Ricertifikim ISMS-ISO 27001;
- Shërbime kontraktuese

Shpenzimet e planifikuara për Shërbime intelektuale dhe shërbime tjera për vitin 2022 janë më të larta për 7% krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2021 për shkak të vëllimit të rritur të materialit për përkthim.

### **2.14 Shpenzime tjera**

Në zërin e Shpenzimeve tjera për vitin 2022 janë planifikuar shpenzime në shumë prej 400.000 denarë që përfshijnë shpenzime për shpalljen e konkurseve dhe publikimeve në gazeta, shpallje të prokurimeve publike, akontacione për tatim të shpenzimeve të papranuara dhe shpenzime të tjera publike që kanë të bëjnë me institucionet publike/shtetërore dhe shpenzime të tjera për punë të paparashikuara.

Shpenzimet e planifikuara për Shpenzime të tjera për vitin 2022 janë më të larta për 8,10% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2021 për shkak të rritjes së nënërit Shpenzime tjera për punë të paparashikueshme.

### **2.15 Mjete për punë ndërtimore**

Në zërin Mjete për punë ndërtimore janë paraparë shpenzimet për zgjidhjet arkitektonike për rikonstruktimin e objektit. Vlera e përgjithshme e llogaritur e kësaj kategorie të shpenzimeve është 330.000 denarë.

Shpenzimet e planifikuara për Mjete për punë ndërtimore për vitin 2022 janë më të ulëta për 77% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2021, sepse në vitin 2021 është bërë rikonstruktimi i pjesshëm të objektit të Agjencisë.

### **2.16 Mjete për pajisje**

Në zërin Mjete për pajisje për vitin 2022 janë planifikuar shpenzime në shumë prej 4.000.000



denarë.

Gjatë vitit 2022, Agjencia do të ketë nevojë edhe për blerje të softuerit të ri dhe hapësirës së diskut për integrim me sistemin për interoperabilitet nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës me të cilën janë obliguar institucionet për lidhje të ndërsjellë teknike. Gjithashtu është planifikuar zëvendësim i konektorëve – suitçeve optike të cilët janë të vjetër nga 10 vjet. Krahas kësaj nevojitet prokurim i pajisjes kompjuterike plotësuese, printerëve, baterive për karrikim të vazhdueshëm të ups-eve dhe pajisjes tjetër teknike informative për nevojat e të punësuarve në Agjencinë.

Shpenzimet e planifikuara për **Mjetet për pajisje** për vitin 2022 janë dukshëm më të lartë krahasuar me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2021.

### **2.17 Mjete të tjera kapitale**

Në zërin **Mjete të tjera kapitale** për vitin 2022 janë planifikuar shpenzime në shumë prej **9.790.000 denarë për:**

- Mobilie për zyrë;
- Licenca softuerike;
- Mbrojtje antivirus për Checkpoint 4400;
- Softuer i ri kompjuterik dhe
- Shpenzime për organizim dhe dhënie të provimeve për agjent nga Sekretariati i përgjithshëm.

Shpenzimet e planifikuara për **Mjete të tjera kapitale për vitin 2022** janë më të larta për 28% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2021.

Shpenzimet e planifikuara për licenca softuerike janë 2.500.000 denarë. Rritja e këtyre shpenzimeve është si rezultat i nevojës për prokurim të Microsoft 365 licenca vjetore për një pjesë të të punësuarve, pastaj prokurim i planifikuar i Sql dhe Biztalk licencave për integrim me sistemin për interoperabilitet të MSHIA dhe prokurim të licencës së re për Oracle.

Shpenzimet për mbrojtje antivirus dhe softuer të ri kompjuterik janë shumë më të rëndësishme sepse Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional si trup mbikëqyrës është pjesë qendrore e sistemit të lidhur informatik përmes të cilit realizohen proceset zyrtare të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet e softuerit të ri kompjuterik do të dedikohen për shtimin e funksionaliteteve dhe ndryshimeve të reja ndaj aplikacioneve softuerike që kanë të bëjnë me krijimin e sistemit të menaxhimit me sigurinë e informatave për autorizimin dhe parevokueshmërinë e shfrytëzuesve. Plotësimet e planifikuara dhe ndryshimet janë për shkak të plotësimit të obligimeve ligjore dhe veprimit sipas rekomandimeve konsultuese të revizioneve të jashtme. Funksionalitetet për autorizimin dhe parevokueshmërinë e shfrytëzuesve paraqesin ruajtje të përhershme të të gjitha veprimeve të ndërmarra nga shfrytëzuesit e sistemeve përkatëse, ruajtjen e përhershme e të dhënave ku kanë pasur qasje shfrytëzuesit, respektivisht logimi me qëllim të mundësimit të parevokueshmërisë së qasjes nga ana e shfrytëzuesit në rast të situatave të ardhshme kontestuese (p.sh, rrjedhja e të dhënave). Prokurimet do të realizohen në pajtim me Ligjin për prokurime publike. Ato konsiderohen si aktivitete investuese duke marrë parasysh kohëzgjatjen dhe madhësinë e vlerës së mjeteve.

Shpenzimet për shfrytëzimin e softuerit për organizimin dhe dhënien e provimeve për të fituar licencën për agjent caktohen në pajtim me prokurimin e kalkuluar të cilin e realizon Sekretariati i përgjithshëm i Qeverisë, në pajtim me të cilën pagesa bëhet nga mjete personale të Agjencisë, si kompensim i paraparë për mirëmbajtje dhe mbështetje të zgjidhjeve sistematike.

### **2.18 Paga dhe kompensime të kalkuluara**

Në zërin **Paga dhe kompensime të kalkuluara**, janë planifikuar shpenzime në shumë prej

35.080.000 denarë për bruto-paga në pajtim me pozitat e plotësuara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci, kompensimet për të punësuarit dhe për ndihmat e tjera në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive. Në vitin 2022, përveç bruto-pagave për të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit të Ekspertëve në Agjenci, gjithashtu janë planifikuar edhe mjete për punësim të ri dhe rritje të mundshme të pagave, në pajtim me vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpenzimet e planifikuara për Paga dhe kompensime të kalkuluara për vitin 2022 janë më të larta për 3% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2021.

### **2.19 Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati**

Në zërin Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati për vitin 2022 janë planifikuara shpenzime në shumë prej 200.000 denarë që kanë të bëjnë me shpenzime për tatimin personal në bazë të pagesave të kompensimeve për anëtarët e jashtëm të Këshillit të ekspertëve dhe të tjerë.

Shpenzimet e planifikuara për Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati për vitin 2022 janë në nivelin e njëjtë krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2021, sipas projekteve për kompensime dhe shpenzime të tjera për të cilat paguhet tatim personal i të ardhurave.

**Në pajtim me kategoritë e detajuara të theksuara të planit financiar, planifikohet shumë prej 350.000 denarë si dallim ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022.**

Në pajtim me nenin 56-a të Ligjit, nëse gjatë vitit të kaluar zyrtar, Agjencia realizon tepriçë të të ardhurave krahasuar me Shpenzimet e realizuara, teprica e realizuar e mjeteve vendoset në fondin rezervë të Agjencisë në shumën e caktuar me planin financiar të Agjencisë.



Shtojca I. AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANÇIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL - PASQYRË ANALITIKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Nr.re nd.	PËRSHKRIMI	MIRATUAR 2021	2021			INDEKSI	PLANI 2022
			Realizuar deri më 30.09.2021	Vlerësim nga 09.09 deri më 31.12.2021	Gjithsej viti 2021		
1	2	3	4	5	6=4+5	7=6/3	8
A	<b>TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA</b>	<b>67.100.000</b>	<b>82.049.679</b>	<b>20.944.479</b>	<b>74.683.128</b>	<b>111</b>	<b>75.600.000</b>
1.1.	Kompensimi mujor nga kontributet (0,8%)	63.000.000	79.240.016	19.141.701	70.186.238	111	71.000.000
1.2.	Kompensime administrative	3.600.000	2.474.110	1.413.777	3.772.336	105	3.800.000
1.3.	Të ardhura nga kamatat	500.000	115.553	389.000	504.553	101	800.000
1.4	Të ardhurat nga shitja e automjeteve zyrtar	0	220.000	0	220.000	0	0
6	<b>SHPENZIMET E PLANIFIKUARA</b>	<b>66.510.000</b>	<b>31.751.481</b>	<b>22.632.514</b>	<b>54.383.995</b>	<b>82</b>	<b>75.250.000</b>
1	<b>MATERIALET E HARRHUARA</b>	<b>610.000</b>	<b>212.169</b>	<b>227.962</b>	<b>440.131</b>	<b>72</b>	<b>610.000</b>
1.1.	Derivate	400.000	167.368	62.763	230.131	58	400.000
1.2.	Materiale për zyre	150.000	0	150.000	150.000	100	150.000
1.3.	Inventar i imët	60.000	44.801	15.199	60.000	100	60.000
2	<b>ENERGJIA E SHPENZUAR DHE SHËRBIME KOMUNALE</b>	<b>1.200.000</b>	<b>662.715</b>	<b>248.518</b>	<b>911.233</b>	<b>76</b>	<b>1.400.000</b>
2.1.	Energjia elektrike	600.000	451.844	169.442	621.286	104	800.000
2.2.	Ujë, shpenzime të tjera komunale dhe ngrohje qendrore	600.000	210.871	79.077	289.948	48	600.000
3	<b>MIRËMBAJTJA INVESTUESE E MJETEVE</b>	<b>280.000</b>	<b>254.843</b>	<b>22.802</b>	<b>277.645</b>	<b>99</b>	<b>30.000</b>
3.1.	Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit për zjarr	30.000	7.198	22.802	30.000	100	30.000
3.2	Instalimi i centralit telefonic	250.000	247.645	0	247.645	99	0
4	<b>SHËRBIME TJEKA</b>	<b>12.440.000</b>	<b>3.937.766</b>	<b>7.062.670</b>	<b>11.000.436</b>	<b>88</b>	<b>15.800.000</b>
4.1.	Mirëmbajtja e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional	2.000.000	1.164.660	436.748	1.601.408	80	4.300.000
4.2.	Mirëmbajtja e pajisjes harduerike IBM	1.200.000	799.568	299.838	1.099.406	92	1.200.000
4.3.	Mirëmbajtja e softuerit për arkiv	300.000	164.020	61.508	225.528	75	600.000
4.4.	Mirëmbajtja e softuerit për kontabilitet	150.000	74.340	75.660	150.000	100	150.000
4.5.	Shërbime për lokacion sekondar	1.200.000	799.992	299.997	1.099.989	92	1.200.000
4.6.	Dërgime postare	440.000	230.918	86.594	317.512	72	500.000

4.7.	Mirëmbajtja higjienike e hapësirave	300.000	122.360	45.885	168.245	56	240.000
4.8.	Sherbime të telekomunikimeve	550.000	266.314	99.868	366.182	67	600.000
4.9.	Sherbime për printim, kopjim dhe konvertim të shkresave	300.000	63.254	23.720	86.974	29	300.000
4.10.	Kompensim për hapësirë parkimi	90.000	84.002	0	84.002	93	60.000
4.11.	Mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve	170.000	122.509	0	122.509	72	250.000
4.12.	Mirëmbajtja e pajisjes teknike	60.000	0	60.000	60.000	100	60.000
4.13.	Riparime të objektit afarist	60.000	55.673	4.327	60.000	100	150.000
4.14.	Organizim të evenimeve për zhvillim të sigurimit pensional me financim kapital	5.000.000	0	5.000.000	5.000.000	100	5.000.000
4.15.	Servisi informativ-financiar	620.000	0	620.000	620.000	100	620.000
<b>5</b>	<b>SHËRBIME TË TRANSPORTIT</b>	<b>60.000</b>	<b>10.964</b>	<b>4.112</b>	<b>15.076</b>	<b>25</b>	<b>60.000</b>
5.1.	Sherbime të transportit	60.000	10.964	4.112	15.076	25	60.000
<b>6</b>	<b>SHPENZIME PËR REKLAM DHE REPREZENTACION</b>	<b>700.000</b>	<b>124.357</b>	<b>346.634</b>	<b>470.991</b>	<b>67</b>	<b>700.000</b>
6.1.	Reprezentacion	400.000	124.357	46.634	170.991	43	400.000
6.2.	Sherbime për printim të materialit reklamues	300.000	0	300.000	300.000	100	300.000
<b>7</b>	<b>QIRAMARRJE</b>	<b>1.010.000</b>	<b>519.613</b>	<b>224.855</b>	<b>744.468</b>	<b>74</b>	<b>1.360.000</b>
7.1.	Marrja me qira e sallave dhe amfiteatrove	30.000	0	30.000	30.000	100	30.000
7.2.	Qiramarrja e linjës së internetit	150.000	56.938	21.352	78.290	52	150.000
7.3.	Marrja me qira e pajisjes	80.000	42.792	16.047	58.839	74	80.000
7.4.	Qiramarrja	750.000	419.883	157.456	577.339	77	1.100.000
<b>8</b>	<b>SHËRBIME TJERA MATERIALE</b>	<b>380.000</b>	<b>162.032</b>	<b>70.762</b>	<b>232.794</b>	<b>61</b>	<b>380.000</b>
8.1.	Prokurimi i revistave, literaturës profesionale, gazetave dhe ngjashëm	50.000	22.700	8.513	31.213	62	50.000
8.2.	Pagesa e kompensimit për këmbim të të dhënave Bursës shpenzime materiale dhe të arkës	200.000	96.380	36.143	132.523	66	200.000
8.3.	Shpenzime për prokurim të mjeteve	60.000	16.800	6.300	23.100	39	60.000
8.4.	Sigurimi teknik dhe patrullues të hapësirave të Agjencisë	35.000	20.352	7.632	27.984	80	35.000
8.5.	Shpenzime për regjistrim dhe pasqyra teknike e mjeteve Motorike	10.000	0	10.000	10.000	100	10.000

8.6.	Shtërbime tjera-shtërbime për deratizim dhe dezinfektim	25.000	5.800	2.175	7975	32	25.000
9	<b>PROVIZION PËR QARKULLIM PAGESOR</b>	60.000	27.117	10.169	37.286	62	60.000
9.1.	provizioni për qarkullim pagesor dhe provizion bankar për blerje të devizave	60.000	27.117	10.169	37.286	62	60.000



10	PREMI PËR SIGURIM	110.000	21.600	48.100	69.700	63	110.000
10.1.	Sigurimi i të punësuarve dhe sigurimi i pasagjerëve për udhëtime zyrtare						
10.2.	Sigurimi i objektivit afarist nga fatkeqësitë	70.000	21.600	8.100	29.700	42	70.000
10.3.	Sigurimi i automjeteve zyrtare	30.000	0	30.000	30.000	100	30.000
11	<b>SHPENZIME RRUGORE DHE DITORE</b>	10.000	0	10.000	10.000	100	10.000
11.1.	Udhëtim zyrtar në vend	1.600.000	1.137	398.863	400.000	25	1.600.000
11.2.	Udhëtim zyrtar jashtë vendit	400.000	1.137	398.863	400.000	100	400.000
12	<b>ANËTARËSIME</b>	1.200.000	0	0	0	0	1.200.000
12.1.	Anëtarësimi vjetor për IOPS	440.000	437.596	0	437.596	99	440.000
12.2.	Anëtarësimi vjetor për OPM	341.000	339.570	0	339.570	100	341.000
12.3.	Anëtarësimi vjetor për vitin 2019 në INFE-OECD	40.000	40.000	0	40.000	100	40.000
12.4.	Anëtarësimi vjetor për Shoqatën e revizorëve të brendshëm	56.000	55.526	0	55.526	99	56.000
13	<b>SHËRBIME INTELEKTUALE DHE TJERA</b>	3.000	2.500	0	2.500	83	3.000
13.1.	Kompensim për anëtarë të jashtëm të Këshillit të Ekspertëve	2.710.000	1.280.649	716.212	1.996.861	74	2.900.000
13.2.	Shërbime tjera – vlerësues, noter	800.000	451.202	169.201	620.403	78	800.000
13.3.	Shërbime përkthimi	20.000	0	20.000	20.000	100	20.000
13.4.	Lektorimi i tekstit	400.000	79.963	29.986	109.949	27	600.000
13.5.	Revizioni i jashtëm	10.000	0	10.000	10.000	100	10.000
13.6.	Shërbime konsultimi	150.000	149.763	0	149.763	100	150.000
13.7.	Trajnime për përsosje profesionale, seminare dhe konferenca	50.000	0	50.000	50.000	100	200.000
13.8.	Kontrolli shëndetësor i të punësuarve	500.000	192.975	307.025	500.000	100	500.000
13.9.	Ricertifikim ISMS-ISO 27001	0	0	0	0	0	250.000
13.10.	Hulumtimi i mendimit publik	30.000	0	30.000	30.000	100	130.000
13.11.	Kontrolli i jashtëm i AMDHP	100.000	99.946	0	99.946	100	30.000
13.12.	Kontrolli i jashtëm i sistemit TI	100.000	0	100.000	100.000	100	0
13.13.	Shërbime kontraktuese	310.000	306.800	0	306.800	99	0
		240.000	0	0	0	0	240.000



14	SHPENZIME TJERA	370.000	171.054	98.875	269.929	73	400.000
14.1.	Shpallja e konkurseve	120.000	94.344	20.965	115.309	96	80.000
14.2.	Akontimet pagësore për tatim të shpenzimeve të papranuara	80.000	0	0	0	0	0
14.3.	Taksa tjera publike	20.000	2.310	2.310	4.620	23	20.000
14.4.	Shpenzime tjera për punë të paparashikueshme	150.000	74.400	75.600	150.000	100	300.000
15	MJETE PËR OBJEKTE NDËRTIMORE	1.430.000	1.132.470	30.000	1.162.470	81	330.000
15.1.	Zgjidhje arkitektonike	30.000	0	30.000	30.000	100	30.000
15.2.	Rikonstruktimi	1.400.000	1.132.470	0	1.132.470	81	300.000
16	MJETE PËR PAJISJE	1.200.000	1.086.329	0	1.086.329	91	4.000.000
16.1.	Pajisje kompjuterike	1.200.000	1.086.329	0	1.086.329	91	4.000.000
17	MJETE TJERA KAPITALE	7.630.000	3.793.606	3.755.511	7.549.117	99	9.790.000
17.1.	Mobile të zyrës	200.000	0	200.000	200.000	100	150.000
17.2.	Licenca softuerike	150.000	116.497	33.503	150.000	100	400.000
17.3.	Mbrojtja e antiviruseit	400.000	0	400.000	400.000	100	400.000
17.4.	Softueri kompjuterik – softuer i ri	6.500.000	3.453.040	3.044.960	6.500.000	100	6.500.000
17.5.	Pjesëmarrje në prokurim të softuerit për organizim dhe dhënie të provimeve për agjentë	130.000	19.449	110.551	130.000	100	240.000
18	PAGAT E KALKULUARA DHE KOMPENSIMET	34.080.000	17.774.58	9.307.347	27.081.934	79	35.080.000
18.1.	Pagat e kalkuluara	32.600.000	16.954.99	9.000.000	25.954.996	80	33.600.000
18.2.	Kompensime dhe ndihma tjera në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive	1.480.000	819.591	307.347	1.126.938	76	1.480.000
19	TATIME DHE KONTRIBUTE QË NUK VAREN NGA REZULTATI	200.000	140.877	59.123	200.000	100	200.000
19.1.	Tatimi personal për kompensime për anëtarët e jashtëm të Keshillit të ekspertëve etj.	200.000	140.877	59.123	200.000	100	200.000

## Shtojca 2. Rezultati i planifikuar financiar për vitin 2022

REZULTATI FINANCIAR	
TË ARDHURAT E PËRGJITSHME RRJEDHËSE TË PLANIFIKUARA	75.600.000
SHPENZIMET E PËRGJITSHME RRJEDHËSE TË PLANIFIKUARA	75.250.000
REZULTATI FINANCIAR NA VITI AKTUAL PARA TATIMIMIT (1-2) QË BARTET NË FONDIN REZERV	350.000

\*Ndryshimi dhe plotësimi i planit financiar bëhet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë vitit, Këshilli i ekspertëve të Agjencisë mund të bëjë ndryshim të Planit vjetor financiar vetëm nëse bëhet fjalë për shpenzime që nuk kanë mundur të planifikohen me kohë. Për realizimin e ndryshimit, nevojitet që të dorëzohet arsyetim të Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë. Ndryshimi mund të bëhet në kuadër të të njëjtit zë por jo më shumë sesa shumën e përgjithshme të shpenzimeve të planifikuara në Planin Financiar të Agjencisë, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Përgatiti/kontrolloi:  
Ilir Ademi

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve  
Maksud Ali

